



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0208

OSHP: 2024/0221

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-Kryetar, Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Ardi” SH.P.K., si dhe OE “MEDPLUS” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE” me numër të prokurimit; 206-23-14103-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 10/05/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE ankues, “Ardi” SH.P.K., me numër; 2024/0208, e datës, 13/03/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE”, për Lot.1 dhe Lot.3, me numër të prokurimit; 206-23-14103-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.
2. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE ankues “MEDPLUS” SH.P.K., me nr.0221/2024, e datës, 15/03/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE”, për Lot.3, me numër të prokurimit; 206-23-14103-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.
3. Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendim të Autoritetit Kontraktues, i datës, 20.04.2024, AK/ Ministria e Shëndetësisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër; 206-23-14103-1-1-1.
4. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorëve ekonomik ankues “Ardi” SH.P.K., si dhe “MEDPLUS” SH.P.K., i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.12.2023, Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE” me numër të prokurimit 206-23-14103-1-1-1. Ndërsa me datën 20.02.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës me të cili ka shpërblyer me kontratë operatorët ekonomik.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 840,999.66€.

OE “Ardi” SH.P.K., dhe OE “MEDPLUS” SH.P.K., kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 05.03.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.03.2024, OSHP ka pranuar ankese nga OE “Ardi” SH.P.K., me nr. 2024/0208 dhe ankesën e OE “MEDPLUS” SH.P.K., me nr.2024/0221 me datën 15.03.2024 lidhur me aktivitetin “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE” me numër të prokurimit 206-23-14103-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ardi” SH.P.K., për ankesën me nr.2024/0208 janë parashtruar si në vijim:

Operatori Ekonomik “Ardi” sh.p.k., konsideron se vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të datës 05.03.2024, Njoftimi mbi vendimin e A (B58 i datës 20.02.2024 me të cilin është rekomanduar për kontratë për Lot 1 dhe U 3 OE Madekos dhe Letra Standarde për Tenderuesin e pasuksesshëm B46 e datës 20.02.2024 me të cilin OE Ardi shpk është njoftuar se oferta e tij nuk është në mesin e ofertave me çmimin më të ulët për Lot 1 dhe Lot 3, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE” per LOT 1 dhe LOT 3 dhe me numër të prokurimit 206-23- 14103-1-1-1. janë marrë në kundërshtim me gjendjen faktike dhe me shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe kjo për arsyetim si në vijim:

1.Fillimisht, siç mund të shihet nga vendimi i AK për të shpërblyer me kontratë OE Madekos shpk, i njëjti për LOT 1 ka ofertuar me çmim prej 378,704.80 Euro dhe për Lot 3 ka ofertuar me çmim 235,627.47 Euro.

2.Këto çmimet janë çmime jo normalisht të ulëta, sepse OE Madekos ka ofertuar me çmim për njësi prej 0.014 cent deri në maksirr.umin prej 0.18 cent për Lot 1 dhe ka ofertuar me çmim për njësi prej 0.0085 cent deri në maksimumin 0.27 cent për Lot 3. Këto çmime me të cilat ka ofertuar ky OE janë çmime jo ekzistente, jo reale dhe të pamundura të realizohen sepse me këtë kosto nuk mund të ofertohej ky mall nga asnjë fabrikë në Kinë, e as kudo në botë. Ky çmim me të cilin ka ofertuar ky Operator Ekonomik, prej më pak se 0.014 cent (pra më pak se një cent e gjysmë për copë), është çmim që as fabrika e prodhimit nuk e ka si kosto të prodhimit të këtij produkti dhe ka mjaftuar AK MSH ti drejtohet prodhuesit se a mund të blihen këto produkte me tëëto çmime. Mirëpo, AK MSH këtë nuk e ka bërë as pas kërkesës për rishqyrtim

3.Çmimin jo normalisht të ulët e bën edhe fakti se kosto e transportit është rritur kohëve të fundit jashtëzakonisht shumë. ashtu që nga 2500\$ sa ka kushtuar një kontenier/ngarkesë e transportit nga Kina deri në portin e Durrësit, tani kushton 8000\$ amerikan. Rrjedhimisht, kjo e rritë koston e mallit jashtëzakonisht shumë ? dhe bën që të jetë e pamundur që OE Madekos të mund ta realizoj kontratën me këtë çmim që ka ofertuar prej 0.014 cent deri në maksimumin prej 0.18 cent për Lot 1 dhe 0.0085 cent deri në maksimumin 0.27 cent për Lot 3. Këtu duhet shtuar se ne konsiderojmë se OE Madekos nuk e ka mallin në stok (në gjendje të gatshme për liferim), e që nënkupton se në momentin që porositet malli nga ky OE i njëjti do të ketë ta pamundur së pari ta blej e aq më pak me çmimin që ka ofertuar, e sidpms kur këto duhet shtuar edhe koston e transportit prej 8000\$ amerikan për një kontenier nga Kina deri në portin e Durrësit.

4.Në anën tjetër. OE "Ardi" sh.p.k.. është Operator Ekonomik i cili është në dijeni i të saktë të koston së blerjes së këtij malli, koston së transportit dhe të gjitha kostove të tjera përcjellëse sepse i njëjti para kësaj kontrate ka furnizuar një Autoritet Kontraktues tjetër me mallra të ngjashme me këto mallra sipas kontratës publike të fituar me këtë Autoritet Kontraktues.

5.Po ashtu, duhet sqaruar se ne si OE "Ardi" sh.p.k., mallin për të cilin kemi I ofertuar e kemi në stok (në gjendje për liferim) për pjesën më të madhe të pozicioneve dhe përkundër që kemi këtë mall në stok dhe e kemi sjellur në Kosovë në kohën kur transporti nga Kina ka qenë vetëm 2500\$ dollarë amerikan për një kontenier, përsëri e kemi pasur të pamundur të ofertojmë nën çmimin minimal për LOT 1 prej 0.024 cent deri ne çmimin maksimal 0.25 cent si dhe për LOT 3 prej 0.0092 cent deri ne çmimin maksimal 0.40 cent sepse siç theksuam j as në fabrikat më të mëdha në Kinë nuk mund të sigurohet ofertimi i mallit me çmimet që ka ofertuar OE Madekos, kur kemi parasysh edhe koston e transportit që është rritur trefish.

6.Për të vërtetuar faktin se këto produkte nuk mund të blihen me këto çmime që ka ofertuar OE MADEKOS në asnjë fabrikë në Kinë, ne po ju dorëzojmë një ofertë për produkte identike të cilën na ka dërguar një nga fabrikat më të mëdha në Kinë, e që është fabrika HEZE YINUO MEDICAL INDUSTRY CO LTD. Kështu për produktin Syringe Disposable Luer slip 5ml, kjo kompani na ka dhënë ofertë I se mund ta blejmë me çmim prej 0.01788 cent, ndërsa OE Madekos për këtë produkt ka ofertuar me çmim prej 0.0167. Pra, ky OE ka ofertuar me një çmim të pamundur sepse ky çmim së pari nuk ekziston as si çmim i blerjen drejtpërdrejtë nga fabrika e Kinës, e aq më pak kur këtij çmimi OE Madekos duhet f i shtoj edhe TVSH, shpenzimet e transportit, shpenzimet fikse si pagat e punëtorëve, tatimet, . kosto e licencës se importit etj. Njëjtë është edhe për produktin tjetër Syringe Dispsable 2ml, ku kompania Kineze ne na ka dhënë ofertë se këtë produkt mund ta blejmë nga kjo kompani me çmim prej 0.017 cent, ndërsa OE Madekos ka ofertuar për këtë produkt çmimin prej 0.014 cent. Njëjtë është edhe për produktin tjetër Syringe Dispsable 10ml, ku kompania Kineze ne na ka dhënë ofertë se këtë produkt mund ta blejmë nga kjo kompani me çmim prej 0.02689 cent, ndërsa OE Madekos ka ofertuar për këtë produkt çmimin prej 0.029 cent me TVSH ndërsa pa TVSh ka ofertuar me çmim prej 0.0269. Pra, ky OE ka ofertuar me një çmim të pamundur sepse ky çmim së pari nuk ekziston as si çmim i blerjen drejtpërdrejtë nga fabrika e Kinës, e aq më pak kur këtij çmimi OE Madekos duhet t'i shtoj edhe TVSH, shpenzimet e transportit, shpenzimet fikse si pagat e punëtorëve, tatimet, kosto e licencës se importit etj. PROVË: Oferta e kompanisë kineze HEZE YINUO MEDICAL INDUSTRY CO LTD.

7.Për të dëshmuar se oferta e OE MADEKOS është jo normalisht e ulët, ne kemi marrë edhe një ofertë nga kompania Forca Healthcare Solution for Excellence in Healthcare. Kjo kompani per produktet I.V Cannula ëith injection port & ëings, ; PTFE catheter 20G dhe 22G na ka dhënë çmim të blerjes çmimin prej 0.068 cent për copë dhe për produktin e njëjtë 24G na ka dhënë çmimin e blerjes prej 0.08 cent për copë. Ndërsa OE Madekos për të njëjtat produkte ka ofertuar me çmim , prej 0.080 cent për copë ku përfshihet edhe TVSH ndërsa pa TVSH ka ofertuar me çmim prej 0.074 cent për copë. Siç shihet OE Madekos ka ofertuar me një çmim të cilin as nuk mund ta blesh produktin nga kompania në Indi me këto çmime që ka ofertuar, e aq më pak kur këtyre çmimeve duhet shtuar shpenzimet fikse si TVSH, shpenzimet e transportit, shpenzimet fikse si pagat e punëtorëve, tatimet. kosto e licencës se importit etj. Prandaj, pa mëdyshje oferta e OE Madekos për Lot 3 dhe Lot 1 është jo normalisht e ulët.PROVË: Oferta

e kompanisë në Indi - Forca Healthcare.

8.OE "Ardi" sh.p.k., është në gjendje që mallin për disa artikuj të cilët ka ofertuar i mund ta liferoj brenda javës në rast se do të ishte shpallur fitues sepse siç thamë të njëjtin e posedon në stok/gjendje. Ndërsa OE Madekos këtë mall konsiderojmë se nuk e posedon në gjendje dhe sipas informacioneve që kemi mallrat nga Kina vonohen më së paku 60 ditë në këtë kohë sepse kanali i Suezit punon vetëm 10% të kohës dhe 90% të kohës tjetër nuk punon dhe rrjedhimisht transporti i mallrave po vonohet deri në 60 ditë minimalisht nga data kur nisen nga Kina. Për të dëshmuar këto pretendime lidhur me kostot e transportit deri në 8000\$ dollarë amerikan për një kontenier dhe kohëzgjatjen e transportit të mallrave deri në 60 ditë nga Kina deri në Durrës, ne kemi kërkuar një ofertë nga kompania ; transportuese VectonNavis shpk. Kjo e fundit na ka dërguar të gjitha detajet e transportit së bashku me koston e transportit dhe kohëzgjatjen e transportit. Kështu, nga ky e-mail mund të shihet se për transportin e mallit nga Kina (Qingdao/Shangahi/Ningbo) deri në Durrës, për një kontenier çmimet sillet nga rreth 6000\$ dollar amerikan deri rreth 8000\$ dollarë amerikan varësisht prej madhësisë së ngarkesës. Më tutje, me këtë e-mail jemi njoftuar se për mallrat nga Kina ngarkesa më e shpejtë që mund të niset zgjatë 60 ditë deri në mbërritje në Portin e Durrësit sipas dokumentit të bashkangjitur në e-mail Nëse shikohet dokumenti i bashkangjitur në këtë e-mail, e të cilin po e bashkëngjisim edhe me .j. këtë kërkesë për rishqyrtim, në të cilën është pasqyruar webfaqja ku mund të bëhet rezervimi i transporteve (booking) shihen datat kur mund të nisen ngarkesat me mallra nga Kina dhe kohëzgjatja e mbërritjes së tyre në portin e Durrësit, e që asnjëra prej tyre nuk mund të mbërrijë në Kosovë para 60 ditësh nga data e nisjes.PROVË: E-mail i OE Ardi i datës 29.01.2024 dërguar kompanisë transportuese VectonNavis;E-mail i kompanisë transportuese dërguar OE "Ardi" sh.p.k., i datës29.01.2024; - Fotografi e VWebfaqes ku mund të bëhen rezervimet e transportit.

9.Nga këto prova vërtetohet fakti se OE Madekos e ka të pamundur t'i liferoj këto produkte në afat prej 45 ditësh kalendarike siç kërkohet me dosjen e tenderit.

10.Se oferta e OE Madekos është jo normalisht e ulët vërtetohet edhe me faktin se p.sh në një aktivitet tjetër të prokurimit të shpallur nga Shërbimi Spitalor Klinik Univerzitar i Kosovës me numër të prokurimit 00220-24-1597-1-1-1, për produktin I.V Placement Unit, Short, LeurType, është paraparë si çmim maksimal që mund të ofertohej çmimi prej rreth 0.25 cent sepse këtu AK ka përllogaritur se ky produkt kur i shtohen shpenzimet që ka një OE për të sjell këtë produkt është e pamundur të ofertohej me një çmim shumë më të ulët se ky çmim. Ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit që po e parashtrojmë këtë ankesë OE Madekos për produktin e njëjtë IV Placement Unit, Short, Leur Type, ka ofertuar me një çmim prej 0.074 cent pa tvsh, pra trefish më të ulët se çmimi real i këtij produkti. Andaj, edhe kjo është një fakt shtesë se oferta e OE Madekos është jo normalisht e ulët ; dhe i mbetet edhe OSHP-së të verifikoj këtë pretendim ankimor.

11.Nga të gjitha këto prova dhe argumente vërtetohet pa mëdyshje fakti se oferta e OE Madekos për Lot 1 dhe Lot 3 përbën çmim dhe ofertë jo normalisht të ulët në kuptim të nenit 61 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të Ligjit për Prokurimin Publik ku përcaktohet se:"Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:2.1. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara. ”

12.Rrjedhimisht, AK MSH minimalisht është dashur të kërkoj sqarime nga OE Madekos dhe prova materiale që argumentojnë se çmimet e ofertuara nga ky operator ekonomik nuk janë jo normalisht të ulëta. Duke qenë se AK MSH nuk ka kërkuar sqarime për këto çmime, e njëjta ka shkelur dispozitën e nenit 61 paragrafi 1 të LPP ku përcaktohet:"Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët ;1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të

dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderin, sipas paragrafin 2. të këtij neni.” ..i ...

13.Në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim konfirmohet fakti se AK MSH fare nuk ka kërkuar sqarime nga OE Madekos lidhur me ofertën e tij në kuptim të nenit 61 të LPP-së. Për më tepër, AK MSH tregohet krejtësisht e njëanshme duke arsyetuar veten se kinse ne si OE nuk paskëm parashtruar pyetje lidhur me vlerat e parashikuara të kontratës, dhe se tani nuk paskëm të drejtë të parashtruar pyetje pretendim. Kjo me të vërtetë nuk don shumë koment, kur një Autoritet Kontraktues në mbrojtje të një Operatori Ekonomik as nuk provon të kuptoj pretendimet tona ankimore dhe na akuzon se nuk paskëm parashtruar pyetje sqaruese. Me këtë rast sqarojmë se ne me kërkesën për rishqyrtim nuk e kemi kontestuar vlerën e paraparë të kontratës me dosjen e tenderit, por kemi kontestuar ofertën e OE Madekos si jo normalisht të ulët, e që këto të dyja kanë një dallim substancial pasi janë dy çështje krejtësisht të ndryshme.

14.AK MSH nuk ka shqyrtuar fare pretendimet ankimore të lartcekura dhe provat materiale që dëshmojnë se OE Madekos e ka pasur të pamundur të ofertoj me çmimet që ka ofertuar e pikërisht për faktin se me çmimet që ka ofertuar ky OE këto produkte nuk mund të blihen as nga fabrikat e aq më pak të sjellën në Kosovë ku kemi shpenzime të cilat u argumentuan më lartë e të cilat fare nuk janë marrë parasysh nga AK MSH.

15.OE Madekos është i papërgjegjshëm sepse i njëjti për ka dorëzuar mostrën e produktit Scalp Vein Infusion Set - Lot 3 në kundërshtim me nenin 37 të Rregullave të Prokurimit Publik, sepse kjo mostër mbanë mbishkrimin “Distributor: Madekos shpk”. Kështu, me nenin 37 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik është përcaktuar se: “37.4 Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet t'i: a. eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE; dhe b. shënohen nga një kod. ”

16.Në qasjen që kemi kërkuar në dosjen e tenderit të OE Madekos na është mundësuar edhe fotografimi i mostrave. Kështu, ne kemi fotografuar mostrën e produktit në fjalë ku shkruan qartë mbishkrimi “Distributor: Madekos shpk”.

17.E njëjta situatë është edhe për mostrën që ka dorëzuar Madekos shpk për produktin Urine Bag Lot 1 - ku edhe në këtë mostër shkruan “Distributor: Madekos shpk”. Njëjtë është edhe për produktin “Syringe Disposable Luer tip” - Lot 1, pastaj për produktin Accu Set Infusion Set Vented; ku shkruan përsëri në mostra “Distributor: Madekos shpk”PROVË: Fotografitë e mostrave të lartcekura.

18.Rrjedhimisht AK MSH ka shkelur dispozitën e nenit 37 paragrafi 4 shkronja a dhe b të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, sepse ka vendosur të shpall të përgjegjshëm një OE si Madekos që ka dorëzuar mostrat me mbishkrimin e emrit të kompanisë së tij Madekos, e të cilat mbi shkrimi nuk i ka mbuluar me stiker ose me ndonjë mbulesë tjetër, e me të vetmin qëllim që AK MSH të ketë më të lehtë përzgjedhjen e tij dhe kjo është në kundërshtim me nenin e lartcekur dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së sepse përbën veprim diskriminues në raport me OE Ardi shpk. Kështu, për këto arsye OE Madekos duhet të shpallët i papërgjegjshëm për LOT 1 dhe LOT 3 sepse ka dorëzuar mostrat me mbishkrimin e kompanisë së tij në kundërshtim me nenin 37 të Rregullores në fjalë, e të cilat mbishkrimet të emrit të kompanisë nuk i ka mbuluar fare me stiker ose me ndonjë mënyrë tjetër në mënyrë që të pamundësohet njëanshmëria e AK në përzgjedhjen e këtij operatori ekonomik.

19.Lidhur me këtë pretendim AK MSH nuk arrin ta kontestoj këtë fakt të pamohueshëm se OE Madekos ka dorëzuar mostrat e tij me mbishkrim dhe nuk i ka mbuluar fare por AK MSH ka konstatuar se kinse edhe ne kemi dorëzuar mostrat me mbishkrim por jep një konstatim shumë të vlefshëm dhe konstaton se NE OE ARDI SHPK I KEMI MBULUAR ME NGJITËS SHËNIMET E KOMPANISË SONË. Në anën tjetër ne kemi potencuar pikërisht këtë fakt se OE Madekos këto mostra i ka dorëzuar me mbishkrim të emrit të kompanisë së tij dhe ato nuk i ka mbuluar me ngjitës. Se OE Madekos këto mostra nuk i ka

mbuluar me ngjitës te pjesa e emrit të kompanisë së tij e vërteton fakti se ne kemi fotografi të mostrave të këtij operatori ekonomik të cilat po i dorëzojmë edhe me këtë ankesë ku shihet se OE Madekos nuk i ka mbuluar këto mostra me ngjitës te pjesa e emrit të kompanisë së tij. Andaj, çfarëdo tendence që këto mostra të mbulohen në këtë fazë të prokurimit me ngjitës qoftë nga AK MSH qoftë nga OE Madekos do të përbente vepër penale të cilën do ta iniciojmë në momentin që kuptojmë se ato mostra janë mbuluar me ngjitës sepse tanimë ne kemi fotografitë e këtyre produkteve që i kemi marrë gjatë qasjes së ofruar në dosjen e OE Madekos e të cilat fotografi në asnjë moment nuk i ka kontestuar AK MSH me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim Andaj, përfundimisht dhe pamëdyshje vërtetohet fakti se OE Madekos është i papërgjegjshëm për këto arsye dhe se AK MSH ka shkelur dispozitën e nenit 37 të Rregullores së lartcekur.

20.Më tutje, OE Madekos është i papërgjegjshëm edhe për arsye se ka dorëzuar autorizimin e një kompani turke ndërsa mostrat e mallrave janë nga Kina AK MSH nuk ka dhënë fare asnjë arsyetim lidhur me këtë pretendim ankimor andaj i mbetet OSHP dhe ekspertit shqyrtues ta trajtoj edhe këtë pretendim ankimor

21.Po ashtu, OE Madekos është i papërgjegjshëm edhe për arsye se i njëjti ka bërë ndërhyrje në mostrën lidhur me LOT 3, pozicioni 3, I.V Canula, ku te pjesa e madhësisë shihet se kemi ndërhyrje te pjesa e përshkrimit 22G/0.80mm/25mm, ku siç mund të shihet nga fotografia e mostrës të cilën e kemi bërë gjatë qasjes se lejuar në dosjen e këtij OE, shihet se është një hapësirë mes numrit 0 dhe ,80mm. dhe po ashtu edhe te pjesa e mbishkrimit “mm” te pjesa e numrit 80 nuk është dashur të ekzistoj fare ky mbishkrim “mm”. ashtu që në vend të mbishkrimit me ndërhyrje që gjendet në mostës 22G/080mm/25mm, mbishkrimi pa ndërhyrje është dashur të jetë 22G/0.80/25mm. Për të vërtetuar këtë fakt mjafton ta shikoni fotografinë e njëjtë ku gjendet edhe mostra e produktit për Lot 3 pozicioni 4 Accu Vein IV Canulla ëith ëings & ëith injecton port, ku shihet se mbishkrimi pa ndërhyrje duhet të jetë pa hapsira dhe pa mbishkrim të “mm”, respektivisht duhet të jetë 24/07/19mm. PROVË: Fotografia për mostrat lidhur me LOT 3 pozicioni 3 dhe 4.

22.Më tutje. OE Madekos është OE i papërgjegjshëm sepse i njëjti ka dorëzuar certifikatën ISO 13485:2016 (MD-QMS), e cila siç mund të shihet ka skaduar më datë 05.10.2022. Rrjedhimisht, i njëjti nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. pika 9.1 & 9.2 - Kërkesa 2. ku është kërkuar që prodhuesi të jetë i certifikuar me ISO 13485, dhe dëshmia dokumentare ka qenë të dorëzohet kopja e certifikatës ISO 13485. OE Madekos ka dorëzuar një certifikatë për ISO 13485 e cila së pari nuk është e prodhuesit por është në emër të Madekos dhe e njëjta siç shihet ka skaduar më datë 05.10.2022. Rrjedhimisht, OE Madekos shpk është operator ekonomik i papërgjegjshëm.

23.Më tutje, OE Madekos ka kërkuar të trajtohen si konfidenciale autorizimet, ISO certifikata, katalogët dhe lista e kontratave me referenca. Kjo është jashtë çdo logjike andaj ne konsiderojmë se OE Madekos nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit për këto dokumente dhe kërkojmë që të njëjtat të rishqyrtohen nga ana OSHP fillimisht, e po ashtu kërkojmë edhe nga ana e Ekspertit Shqyrtues të Prokurimit të shqyrtoj të gjitha këto dokumente në të cilat nuk na është ofertuar qasje në mënyrë krejt të kundërligjshme.

24.Po ashtu kërkojmë nga ana e OSHP dhe ekspertit shqyrtues të rishqyrtohen edhe dokumentet e prodhuesit të dorëzuara nga OE Madekos për Lot 1 dhe Lot 3 sepse as këto dokumente nuk na janë ofruar për qasje dhe mendojmë se as këto nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit.

25.OE Madekos nuk ka dorëzuar edhe informatat e biznesit me datë dhe nuk dihet se të cilës periudhë kohore janë ato informata dhe se a ka pasur ndryshime ndërkohë, pasi që nuk përmbajnë fare datën e lëshimit të tyre nga ARBK. Rrjedhimisht, nuk është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit 7.1&7.2, kërkesa 1 dhe evidenca 1.

26.OE Madekos vlerësojmë se nuk ka dorëzuar as autonzimin nga prodhuesi dhe kërkojmë që ky autorizim të rishqyrtohet se a i përmban te gjitha kerkesat sipas dosjes kërkesave të dosjes së tenderit të parapara me kërkesën 9.1&9.2., pasi që ky autorizim nuk na është ofruar me rastin e qasjes në dosjen e tenderit të OE të rekomanduar për kontratë.

27.Kërkojmë nga OSHP dhe ekspertit shqyrtues të rishqyrtoj se a janë dorëzuar CE I Certifikata, katalogu i prodhuesit dhe a është ky katalog në përputhje me specifikat teknike të produktit. Më tutje nuk na është ofruar qasje as në kontratat e realizuara nga OE në tri vitet e shkuara dhe as referencat e as raportet e pranimit 1.5 herë në vlerë të lotit. Pra, praktikisht neve na është pamundësuar qasja në 90% të dokumenteve të dorëzuar nga OE Madekos dhe kjo pamundëson ushtrimin efektiv të kërkesës për rishqyrtim. Andaj, kërkojmë që OSHP dhe eksperti shqyrtues të rishqyrtoj të gjitha dokumentet që ka dorëzuar OE Madekos sepse ne vlerësojmë se ky OE nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

28.Po ashtu, në kërkesën për qasje në dosjet e tenderit të OE të lartcekur, OE Ardi shpk ka kërkuar qasje në komplet dosjet dhe në veçanti në katalogë dhe certifikata, në formular të tenderit, në oferta financiar, mirëpo AK MSH nuk i ka ; dhënë qasje OE Ardi shpk në më shumë se 90% të dokumenteve të kërkuara.

29.Kjo formë e mbajtjes sekrete e dokumenteve siç janë katalogjet, kontrata e realizuara dh.e referencat, pastaj autorizimet.e prodhuesit etj, përbëjnë shkelje të kushteve të parapara me nenin 11 të LPP-së, e cila dispozitë rregullon se kur një informatë apo dokument mund të klasifikohet si sekret afarist. Rrjedhimisht, ne kontestojmë të gjitha dokumentet që ka dorëzuar OE Madekos e të cilat kemi kërkuar që të rishqyrtohen nga ana e AK MSH. mirëpo kjo nuk është bërë nga AK MSH dhe kjo përbën diskriminim dhe shkelje të nenit 11 të LPP-së. Andaj, AK MSH ka shkelur dispozitën e nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, dhe paragrafi 4 dhe 5 të LPP-së, sepse nëse këto dokumente kanë qenë sekrete afariste atëherë AK MSH ka qenë e obliguar të përgatis versionin e "pastëruar" të çdo dokumenti dhe të na dërgoj në mënyrë që në të shohim dhe të bindemi se OE Madekos ka plotësuar kërkesat e dosjes sr tenderit.

30.AK MSH nuk ka trajtuar fare asnjërin prej këtyre pretendimeve ankimore dhe kjo dispozitë ligjore nga neni 11 i LPP është injoruar dhe po injorohet edhe nga ana e OSHP pa as edhe nje arsyetim e as sqarim.

31.Sa i përket arsyetimit të AK MSH se ne OE Ardi shpk, për Lot 1 kemi ofertuar me . një vlerë prej 41,035.60 Euro mbi buxhetin e parashikuar, sqarojmë se deri te ky çmim është ardhë për shkak se siç kemi argumentuar me prova materiale shpenzimet e transportit janë rritur dukshëm andaj kur kemi përllogaritur ofertën tonë është dashur patjetër të merret në konsideratë fakti se shpenzimet e transportit janë rritur dhe për disa pozicione për të cilat mallin nuk e kerini në stok duhet përllogaritur edhe kjo vlerë e shpenzimeve dhe kur kjo merret në konsideratë ka qenë e pamundur për ne të ofertojmë me një çmim tjetër.Tejkalimi i ofertes sonë është rreth 10% dhe deri te ky tejkalim ka ardhur për arsye se shpenzimet e transportit janë rritur dhe kostot tjera bëjnë që të jetë e pa mundur që të ofertohej nën këtë çmimi.

- Pretendimet ankimore ndaj OE ankues “Agani LTD” – Shpk, si ne vijim:

OE Agani LTD është shpallur i pasuksesshëm për LOT 1, mirëpo ne mendojmë se ky OE është dashur të shpallet i papërgjegjshëm sepse i njëjti po ashtu ka dorëzuar për Lot 1 mostrën per artikullin nr 3 Examination Gloves me mbishkrimin “Distributor for kosovo: Agani Ltd Shpk”, dhe ky mbishkrim nuk është i mbuluar me asnjë stiker apo në ndonjë mënyrë tjetër, veprim ky në kundërshtim me nenin 37.4 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. AK MSH nuk ka arritur me asnjë argument dhe asnjë provë materiale të kontestoj këtë pretendim ankimor dhe as që e ka trajtuar të njëjtin.

Për më tepër çmimet më të cilat ka ofertuar OE Agani Itd shpk, janë jo normalisht të ulta sepse ka ofertuar me çmim për njësi prej 0.017 cent deri në maksimumin prej 0.25 cent për Lot 1. Këto çmime me të cilat ka ofertuar ky OE janë çmime jo ekzistente, jo reale dhe të pamundura të realizohen sepse me këtë kosto nuk mund të ofertohej ky mall nga asnjë fabrikë në Kinë, e as kudo në botë. Ky çmim me të cilin ka

ofertuar ky Operator Ekonomik, prej më pak se 0.017 cent është çmim që as fabrika e prodhimit nuk e ka si kos, to të prodhimit të këtij produkti dhe ka mjaftuar AK MSH t'i drejtohet prodhuesit se a mund të blihen këto produkte me këto çmime. Siç argumentuam më lartë ne kemi dorëzuar ofertat e kompanisë Kineze dhe asaj nga India me të cilat dëshmohet se me këto çmime që ka ofertuar kompania Agani LTD për Lot 1 janë çmime jo normalisht të ulëta sepse me të njëjtat nuk mund të blihen këto produkte as nga fabrika e aq më pak të ofertohej me të njëjtat.

Çmimin jo normalisht të ulët e bën edhe fakti se kosto e transportit është rritur kohëve të fundit jashtëzakonisht shumë, ashtu që nga 2500\$ sa ka kushtuar një kontener/ngarkesë e transportit nga Kina deri në portin e Durrësit, tani kushton 8000\$ amerikan. Rrjedhimisht, kjo e rritë koston e mallit jashtëzakonisht shumë dhe bën që të jetë e pamundur që OE Agani të mund ta realizoj kontratën me këtë çmim që ka ofertuar prej 0.017 cent deri në maksimumin prej 0.25 cent për Lot 1. Këtu duhet shtuar se ne konsiderojmë se OE Agani nuk e ka mallin në stok (në gjendje të gatshme për liferim), e që nënkupton se në momentin që porositet malli nga ky OE i njëjti do të ketë ta pamundur së pari ta blej e aq më pak me çmimin që ka ofertuar, e sidomos kur këto duhet shtuar edhe koston e transportit prej 8000\$ amerikan për një kontener nga Kina deri në portin e Durrësit. As këto pretendime ankimore nuk janë shqyrtuar fare nga ana e AK MSH andaj mbetet që të njëjtat të vlerësohen nga ana e OSHP dhe ekspertit shqyrtues.

Më tutje OE Agani LTD ka dorëzuar autorizimin nga kompania Maxter Giove Manufacturing SBD BHD - Malaysia, pa nënshkrim dhe pa vulë të kësaj kompanie. Mirëpo AK MSH fare nuk ka shqyrtuar e as nuk ka komunikuar me prodhuesin se a është i vlefshëm ky autorizim.

Po ashtu katalogu i dorëzuar nuk ka të dhëna për të gjitha produktet rreth specifikave teknike për Lot 1 dhe po ashtu nuk janë dorëzuar mostrat për të gjitha produktet siç kërkohet me dosje të tenderit.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE "Ardi" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 11, 61, 72, LPP-së si dhe neni 37.4, i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik. Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP, që të merr: Vendim të Apropohet, si e bazuar ankesa e OE "Ardi" SH.P.K., Anulohet, njoftimi për dhënie të aktivitetit të prokurimit, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

- Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim "Ardi" SH.P.K.,

E konsideron si të bazuar pretendimin e juaj ankimor në lidhje me vlerat e ofertës rekomanduar për dhënie të kontratës, duke marrë parasysh se vlera e parashikuar në DT kanë qene: Për Lot 1 = 410,111.24 € dhe - Për Lot 3 = 243,313.86 €. Ju keni ofertuar për Lot 1 në vlerën 451,146.84 euro, ose 41,035.60 euro mbi buxhetin e parashikuar, ndërsa për Lot 3 në vlerën 242,204.76 euro.

Oferta e rekomanduar për dhënie të kontratës është në vlerat e ofertës: Për Lot 1 = 378,704.80 € dhe Për Lot 3 = 235,627.47 €. Ndryshimi në mes vlerave të parashikuara në DT për këto dy Lote dhe ofertave të shpërblyera me kontrate është rreth 3% respektivisht 8%.

Si mund ta kontestoni vlerën e ofertave të shpërblyera me kontrate, përderisa nuk e keni kontestuar me pyetje sqaruese vlerat e parashikuara në tenderim. Të vetmen pyetje sqaruese që ju e keni adresuar në fazën e tenderimit me dt. 26.12.2023, ka qene për shtyrje të afatit për ofertim, që d.m.th. të gjitha aspektet tjera për juve si OE kanë qene në rregull.

Sa i përket pretendimit në lidhje me ISO 13485 të OE Madekos, nuk qëndron ky pretendim, meqenëse kjo certifikate nuk ka qene fare kriter i NJK dhe DT, por ky OE e ka ofruar këto certifikate pa u kërkuar në tender.

Në NJK dhe DT është kërkuar që prodhuesi të jetë i Certifikuar me ISO 13485, e jo OE. Në kërkesën tuaj për rishqyrtim ju keni përfshirë pretendime që nuk janë subjekt i kësaj lende dhe as që janë relevante për trajtim. Komunikimet e juaja me prodhuesit e ndryshëm nuk janë relevante për AK-MSH dhe në baze të

tyre nuk mund ta trajtojmë ndonjë oferte si Jo-normalisht te ulet, përderisa oferta është brenda vlerës dhe shume e afërt me tavanin e planifikuar.

Sa i përket pretendimit për mostrat e OE Agani për Lot 3, nuk qëndron ky pretendim, meqenëse ne DT nuk janë kërkuar mostrat për secilin produkt, por janë kërkuar për njërin dimension nga llojet e artikujve, shih dëshminë për kriterin nr. 6 te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kërkesa 6. Ofertuesi se bashku me ofertë, duhet që të sjellë nga një moster te produktit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 6. Ofertuesi para hapjes se tenderit, se bashku me ofertë, duhet të sjellë nga një mostër te produktit (për njërin dimension nga llojet e artikujve). OE Agani i ka ofruar mostrat për njërin dimension nga llojet e artikujve.

Edhe ju si ofertues i keni ofruar mostrat ne mënyrë te ngjashme, me nga një ngjitës ku vërehet emri i kompanisë tuaj, andaj pretendimi juaj për konkurrentet nuk është i bazuar përderisa edhe ju i keni mostrat e identifikuar.

Sa i përket pretendimit për autorizimin e OE Agani për Lot 1, nuk qëndron ky pretendim, meqenëse OE Agani e ka ofruar autorizimin e prodhuesit Maxter se bashku me certifikatat e kërkuara dhe mostrat. AK ka vlerësuar se ky autorizim i plotëson kërkesat e kriterit sipas NJK dhe DT ku është kërkuar që autorizimi të përmbajë të dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, web faqja etj, për mundësi te verifikimit. Ky OE ka qene i pasuksesshem me çmim me te larte se sa OE i rekomanduar dhe OE është pajtuar me vendimin e AK.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MEDPLUS” SH.P.K., për ankesën me nr.2024/0221 janë parashtruar si në vijim:

"Pretendimet e OE ankues: “Fillimisht ne sqarojmë se kemi ofertuar për Lot 1 dhe 3, ndërsa arsyeja e eliminimit realisht ndërlidhet me Iso certifikatën që e kemi dorëzuar për produktin për Lot 1 për pozicionin 1 (madhësive tape 5cmx5m-jo të letrës) dhe nuk ka të bëjë fare me Lot 3, ndërsa ne jemi eliminuar për të dy lotët me arsyen e lartpërmendur e që realisht ka të bëjë vetëm për Lot 1. Loti 1 nuk duhet të ndikojë në rezultatin e Lot 3 sepse dokumentet/Iso certifikatat që janë dorëzuar për Lot 1 janë të tjera, ndërsa për Lot 3 janë të tjera. Pra Iso certifikatat janë dorëzuar të veçanta për Lot 1 dhe tjera të Veçanta për Lot 3, sepse produktet dallojnë për Lot 1 në krahasim me Lot 3, prandaj edhe janë ndarë në Lote këto produkte. Nuk mund të eliminohe mi për Lot 3 me arsyen e eliminimit që na është dhënë për Lot 1, sepse dëshmitë dallojnë dhe janë dorëzuar të ndryshme për Lotet përkatëse. Realisht secili Lot është një tender i veçantë dhe duhet të trajtohet si i tillë, prandaj dokumentet si Iso Certifikatat që janë dorëzuar për Lot 1, nëse janë të parregullta ose jo me validitet atëherë mund të eliminohe mi për Lot 1 por nuk mund të eliminohe mi edhe në Lot 3 për këtë dokumente. Ky veprim bie ndesh me nenin 56.3 të LPP-së, sepse nuk mund të eliminohe mi për një kërkesë që nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit. Po ashtu edhe neni 45.24 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, e përcakton qartë: “Bazuar në nenin 56.3 të LPP, tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe / ose në dosjen e tenderit. Pra, në dosje të tenderit nuk ka qenë e cekur që nëse ndonjë dëshmi e ofruar për Lot 1 nuk plotëson kërkesën apo është dokument pa afat vlefshmërie apo i parregullt atëherë do të eliminohe mi edhe nga Loti tjetër kjo kompani. Lotet janë aktivitet të veçanta por për shkaqe efikasiteti dhe ekonomikiteti përfshihen në një aktivitet të prokurimit, prandaj një arsye e eliminimit që është për Lot 1 nuk duhet të vlejë edhe për Lot 3 sepse Iso certifikata është dorëzuar vetëm për Lot 1 dhe kjo është shumë e qartë, prandaj në këtë rast ne po diskriminohe mi dhe nuk po trajtohe mi barabartë. Për më tepër ky veprim i AK-së rrezikon dëmtimin e buxhetit në vlerë prej 66,615.11 euro për Lot 3, pasi që ne kemi ofertuar në vlerë

prej:169,012.36 euro, kurse OE i rekomanduar për kontratë në vlerë prej:235,627.47 euro. Me dt.05.03.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK[1]ja me arsyetimin se pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara. Në lidhje me pretendimet tona ankimore autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret të bazuar në dispozita ligjore. Sqarojmë se secili Lot është një tender i veçantë dhe duhet të trajtohet si i tillë, prandaj të gjitha dokumentet si Iso Certifikatat që janë dorëzuar për Lot 1, nëse janë të parregullta ose jo me validitet atëherë mund të eliminohehi vetëm për Lot 1, por nuk mund të eliminohehi edhe në Lot 3 për këto dokumente. Autoriteti kontraktues është munduar të ndërlihdh me deklaratën nën betim arsyen e eliminimit, mirëpo ju sqarojmë se kjo ndërlihdhje nuk mund të bëhet për shkak se kemi të bëjmë me dokumente të ndara dhe të ofruara ndaras për lotet përkatëse, prandaj duhet dalluar këto dëshmi dhe duhet trajtuar veçmas këto dokumente. Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë, konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse ne jemi eliminuar pa të drejtë edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse ne jemi operator ekonomik i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët. Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke u eliminuar pa të drejtë në këtë aktivitet të prokurimit. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së, e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Nuk është marrë në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “MEDPLUS” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 69 LPP-së si dhe neni 40 dhe 45 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik. APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE MEDPLUS SH.P.K.&RADIX PHARM SHPK për Lot 3 ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për Lot 3 dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

-Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim MEDPLUS” SH.P.K.-

“Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore AK-MSh i konsideron si te pa bazuar pretendimin e juaj ankimor ne lidhje me kërkesën qe te shpërbleheni me kontrate për Lot 3, duke arsyetuar se arsyeja e eliminimit ndërlihdhet me Iso certifikatën që e keni dorëzuar për produktin për Lot 1 për pozicionin 1 (madhësive tape 5cmx5m-jo të letrës) dhe sipas jush nuk ka të bëjë fare me Lot 3.

Ne lidhje me këtë çështje ne ua rikujtojmë se ne ofertën tuaj ju si lider i konsorciumit keni plotësuar Deklaratën nen Betim sipas Aneksit 2 te DT, ne te cilën nder te tjera theksohet se: Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti oso deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese. Siç jeni te njoftuar gjatë procesit te vlerësimit te këtij aktivitetit, komisioni i vlerësimit ka vërejtur se ju keni dorëzuar certifikatën ISO 13485:2016 për prodhuesin Forlong Medical Co., Ltd - China me nr. te certifikatës: 47014 , ne te cilën figuron periudha e validitetit deri me datë: 18.10.2024, ndërsa sipas website e prodhuesit Forlong Medical Co., Ltd ku është e publikuar e njëjta certifikate me te njëjtin nurnër (47014) është vërejtur se figuron me afat te skaduar me datë: 18.10.2022, Ekziston edhe konfirmimi me shkrim nga autoriteti certifikues ”NQA” se certifikata ISO 13485:2016 e prodhuesit Forlong Medical Co., Ltd e cila është prezantuar ne këtë tender nga ana juaj me Numër: 47014 ka skaduar

dhe është anuluar në Tetor të vitit 2022. Certifikata e ofruar nga ana juaj nuk është valide, është e modifikuar me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme të përmbushet kriteri sipas kërkesës nr. 2 të dosjes së tenderit të aftësitë teknike dhe/ose profesionale, duke përdorë një certifikate të pavlefshme dhe me informata të pasakta. Në rastet e tilla oferta juaj eliminohet si tërësi pasi që bie ndesh me Deklaratën nën Betim që e keni ofruar si me poshtë: **Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM**

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: MEDPLUS SH.P.K. deklaroj nën betim se jain i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë Nr. 04/L-042 . i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Unë vërtetoj se e kani' lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit. Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur të nenit 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 18/03/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0208/24 dhe me datën 22/03/2024 ankesën me nr. 0221/24, ndërsa me datë 29/03/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0208 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-se për Lot 1 dhe Lot 3.

Ndërsa për ankesën 2024/0221 rekomandimi si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK -se për Lot 3.

Raportin e ekspertizës me nr.208/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, pajtohet, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.221/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, pajtohet, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

-Vlerësimi i pretendimit ankimor të OE “Ardi” SH.P.K., ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/0208 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues lidhur me ofertën e OE MadeKos: OE ankues, i pakënaqur me vendimin e AK-se për Lot 1 dhe Lot 3 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK-se dhe njëherit në ankesën e tij të deponuar në OSHP, pretendon se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59 të LPP-se, lidhur me vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues është ankuar për Lot 1 dhe lot-in 3 dhe njëherit pretendimet e tij ankimore kanë të bëjnë me ofertën e te rekomanduarit për kontrate. Vlen të përmendet fakti se autoriteti kontraktues këtë aktivitet të prokurimit e ka ndare në (4) Lote dhe poashtu në dosjen e tenderit e ka publikuar vlerën e parashikuar për secilin Lot veç e veç.Për: Lot 1 = 410,111.24 € , Lot 3 = 243,313.86 €.

OE ankues për Lot 1, e ka dorëzuar ofertën e tij me vlerën e përgjithshme të ofertës: 451,146.84 euro, pra mbi 40,000.00 euro mbi vlerën e parashikuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se fakti që OE ankues e ka tejkalluar vlerën e parashikuar të Lot-it 1, e bën palë pa interes juridik e material sipas nenit 4.1.26 të LPP-se. I njëjti e arsyeton çmimin me shërbimet e transportit të cilat sipas OE ankues janë ngritur shumë.

OE ankues, pretendon se OE i rekomanduar për kontrate, për Lot 1 dhe Lot 3 ka ofruar çmime jonormalishte të ulëta, i njëjti i referohet çmimeve të dhëna në paramasë dhe paralogari. Lidhur me këtë pretendim OE ankues, pretendon kryesisht se rritja e çmimit të transportit të mallrave e bën të pamundur që OE i rekomanduar për kontrate të furnizojë autoritetin kontraktues dhe njëherit lidhur me këtë pretendim në ankesën e tij i ka bashkangjitur edhe disa çmime të transportit të mallrave.

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm, për faktin se sipas nenit 61 të LPP-se, vlerësimi i çmimeve është e drejtë e autoritetit kontraktues, çmime të cilat në rastin konkret për autoritetin kontraktues nuk janë çmime jonormalishte të ulëta. Arsyetimin e çmime AK-ja e ka dhënë edhe në vendimin e kërkesës për rishqyrtim. Eksperti shqyrtues sqaron faktin se çmimi total i dhënë nga OE i rekomanduar për kontrate për të dy lotët është afër vlerës së parashikuar nga autoriteti kontraktues.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar mostrat në kundërshtim me nenin 37.4 të rregullores për prokurim publik 001/2022, me arsyetimin mostrat mbajnë mbishkrimin e distributorit Madekos Shpk, dhe ky fakt sipas OE ankues është në kundërshtim me nenin 37.4 të Rregullores së përmendur më lartë:

Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet t'i: a. eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues sepse nuk është obligim i OE ankues që me rastin e dorëzimit të mostrave të mbulojë dhe të vendosë kode të mostrave. Çështja e dorëzimit të mostrave dhe trajtimit të mostrave duke përfshirë mbrojtjen e tyre definohet në paragrafin 5 të nenit 37 të rregullores:

37.5 Personi që eliminon shenjat nga mostrat dhe që vendos kodet nuk do të marrë pjesë në procesin e vlerësimit dhe nuk do të bëjë të ditur identifikimin e mostrave për anëtarët e komisionit të vlerësimit.

Pra, sipas paragrafit 5 të nenit 37 të cituar më lartë, nuk është obligim i operatorit ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit që të mbulojë, prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues.

OE ankues pretendon se i rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar mostrat nga Kina ndërsa autorizimi është nga një kompani Turke. Eksperti shqyrtues referuar edhe paramasës ku OE-te e kanë deklaruar prodhuesin, sqaron se në rastin konkret OE i rekomanduar për kontrate për produktet e ofruar i ka deklaruar prodhuesit nga: Kina, India dhe Turqia dhe për të njëjtit prodhues në ofertën e tij i ka dorëzuar autorizimet, Iso standardet dhe certifikatat CE. Prandaj ky pretendim nuk qëndron.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate ka ndërhyrë në mostra – të pjesa e përshkrimit, konkretisht të pjesa si më poshtë: Ndërsa sipas OE ankues, hapësira nuk duhet të jetë, por duhet të jetë e ngjitur, si më poshtë:

Eksperti shqyrtues sqaron nuk përbën ndonjë provë deklarimi i OE ankues që në atë pjesë ka ndërhyrje dhe njëherit kjo çështje për tu vërtetuar duhet të dërgohet pranë organeve të hetuesisë. Eksperti shqyrtues mund të jep vlerësimin se në këtë rast pretendohet për ndryshim të specifikave nga i rekomanduar për kontratë.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pretendon se OE MadeKos, certifikatën me nr. 13485/2016 e ka dorëzuar në ofertën e tij me afat të skaduar, e cila sipas OE ankues ka skaduar me datën: 05.10.2022.

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron ky pretendim, sepse kërkesa nr. 2 tek kapaciteti teknike dhe profesional është kërkuar që prodhuesi të jetë i certifikuar me certifikatën 13485 dhe jo operatori ekonomik. Në rastin konkret eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontrate, sqaron se përveç certifikatës 13485/2016 e cila është në pronësi të OE Madekos (e ka dorëzuar

si dokument i cili nuk është kërkuar ne DT) i ka dorëzuar ne ofertën e tij edhe Iso certifikatat e prodhuesve dhe CE certifikatat.

Sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me autorizimet e prodhuesve, eksperti shqyrtues vlerëson autorizimet e prodhuesve gjenden ne ofertën e te rekomanduarit për kontrate, për te cilat OE ankues ka kërkuar ekzaminimin e dëshmimeve me arsyetimin se me rastin e kërkesës për qasje ne dokument nuk kemi mundur ta shohim sepse i rekomanduari për kontrate ka paraqitur kërkesë për sekret afarist. Edhe sa i përket kontratave dhe referencave OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar kontrata ne vlere mbi 2,500,000.00 euro.

Sa i përket katalogëve, eksperti shqyrtues sqaron se i rekomanduari për kontrate i ka dorëzuar edhe katalogët për Lot 1 dhe Lot 3 për te cilët OE ankues pretendon se nuk i ka dorëzuar. Prandaj nuk qëndron pretendimi i OE ankues.

OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate ka pasur ndryshime ne statusin e biznesit dhe për këtë fakt nuk ka dorëzuar certifikatën e biznesit me ndryshime. Eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim sepse i rekomanduari për kontrate e ka dorëzuar certifikatën e biznesit dhe ne faqen nr. te certifikatës thuhet:

Sipas te dhënave eshë ndërruar vetëm tipi i biznesit nga N.SH.T ne Sh.P.K.

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE ankues lidhur me ofertën e OE Agani LTD: Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ka pretendime ankimore edhe kundër ofertës e OE Agani LTD, për te cilin pretendon ngjashëm sikurse për OE te rekomanduar për kontrate, se OE Agani LTD ka ofruar çmime jonormalishte te ulëta dhe poashtu pretendon se i njëjti i ka dorëzuar mostrat me mbishkrimin Agani LTD. Eksperti shqyrtues lidhur me këto dy pretendime ka dhënë sqarime si me sipër, prandaj, vlerësoj se nuk qëndrojnë këto dy pretendime.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, se OE Agani ltd, ka dorëzuar autorizimin e prodhuesit Maxter te pa vulosur dhe te pa nënshkruar, qëndron ky pretendim sepse pas ekzaminimit eksperti shqyrtues vlerëson se fillimisht është dashur te verifikohet dhe ti drejtohet prodhuesit me shkrim.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE Agani LTD, nuk i ka dorëzuar katalogun për produktet e kërkuara për Lot-in 1, nuk qëndron për faktin se ne ofertën e tij gjenden katalogët veç e veç për secilin produkt te kërkuar nga AK-ja, dhe ne katalogët e dorëzuar i ka nënvizuar te gjitha specifikat teknike.”

-Vlerësimi i pretendimit ankimor të OE “MEDPLUS” SH.P.K., ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/0221 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, për Lot 3, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se AK-ja, kryesisht nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 te LPP-se.

Autoriteti kontraktues, pas përfundimit te vlerësimit te ofertave, e ka njoftuar OE ankues me letrën standarde te tenderuesit te eliminuar, me arsyetimin se:

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, gjate vlerësimit te ofertave, konkretisht ofertën e OE ankues ka vërejtur se Iso certifikata me nr. 13485/2016, e dorëzuar nga OE ankues është me afat skadence deri me: 18.10.2024 dhe për te njëjtën certifikatë AK-ja ka kërkuar sqarim nga lëshuesi i certifikatës me arsyetimin se gjate verifikimit te certifikatës Iso 13485/2016 ne web faqen e lëshuesit te certifikatës janë vërejtur ndryshime nga ajo e dorëzuar ne ofertën e OE ankues.

Prandaj, me datën: 29.01.2024, AK-ja i është drejtuar me shkrim lëshuesit te certifikatës dhe te njëjtit me datën: 30.01.2024, ne përgjigje ka deklaruar se certifikata ne fjale ka skaduar dhe është anuluar ne tetor te vitit 2022.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesën e tij pretendon se certifikata ne fjale nuk ka te beje me Lot-in 3 por me Lot-in 1.

Eksperti shqyrtues, pas analizimit te kërkesës se dosjes se tenderit lidhur me Iso standardin e kërkuar, vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, sepse ne kërkesën e vendosur ne dosjes te tenderit, AK-ja ka kërkuar qe për te gjitha lotët te dëshmohet me Iso certifikatën 13485.

Kërkesa nr. 2 e DT-se:Kërkohet qe prodhuesi te jetë i certifikuar me ISO 13485.

Bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit dhe verifikimit te bere nga ana e AK-se, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ardi” SH.P.K., dhe “MEDPLUS” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese/teknik është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertes shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ardi” SH.P.K., dhe “MEDPLUS” SH.P.K., janë të pa bazuara.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një

aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli shqyrtues lidhur me ankesën nr. 0208/2024, e ka analizuar Raportin e ekspertit shqyrtues, të hartuar me kërkesën panelit për të shqyrtuar bazën ligjore të pretendimeve ankimore, të Operatori ekonomik “Ardi” SH.P.K., është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertes shqyrtuese. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik “Ardi” SH.P.K., duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, të datës 20.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE” me nr. të prokurimit: 206-23-14103-1-1-1, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-se për Lot 1 dhe Lot 3.

Paneli shqyrtues lidhur me ankesën nr. 0211/2024, e ka analizuar Raportin e ekspertit shqyrtues, të hartuar me kërkesën panelit për të shqyrtuar bazën ligjore të pretendimeve ankimore, të Operatori ekonomik “MEDPLUS” SH.P.K., është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertes shqyrtuese. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik “MEDPLUS” SH.P.K., duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, të datës 20.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE” me nr. të prokurimit: 206-23-14103-1-1-1, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-se për Lot 3.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa OE “Ardi” SH.P.K dhe ankesa OE “MEDPLUS” SH.P.K., refuzohen, pasi ankuesit nuk kanë arritur të dëshmojnë me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE” me nr. të prokurimit: 206-23-14103-1-1-1. Përfundimisht Paneli shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE” me nr. të prokurimit: 206-23-14103-1-1-1.

Po ashtu Paneli shqyrtues thekson se në bazë të nenit 59.1 të LPP-së, Autoriteti kontraktues themelon një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave dhe të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, ndërsa në anën tjetër ankuesit Panelit shqyrtues, nuk i kanë ofruar ndonjë prove apo dëshmi bindëse, se Operatori ekonomik i rekomanduar, ka ofertuar me dokumente të jo valide dhe të papërshtatshme. Këtë konstatim e ka dhënë edhe Eksperti shqyrtues sipas autorizimit të tij të përcaktuar me nenin 112 dhe 113 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në nenin 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankesave të operatorit ekonomik; "Ardi" SH.P.K dhe "MEDPLUS" SH.P.K. vendosi t,i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatorët ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Ardi SH.P.K., MEDPLUS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: